



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:189142

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05647852

P.nr.98/2023

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë, përmes gjyqtarit Sadri Krasniqi, me sekretaren juridike Donjeta Zenuni, në çështjen penale kundër të pandehurit S. B. nga fshati ....., për shkak të veprës penale: asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas aktakuzës së PTH-së në Gjilan, PP.II.nr.1226/2023, të datës 29.08.2023, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 02.04.2024, në prezencën e Prokurores së Shtetit Kujtesa Fazliu, të pandehurit S. B., publikisht komunikoi, ndërsa më dt.02.05.2024, përpiloi këtë,

### A K T G J Y K I M

I pandehuri ,

**S. B.**, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga babai Z. dhe e ëma F., e lindur A., i lindur më datë ..., në ....., me nr. personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i dy fëmijëve, i punësuar në botën e jashtme, i gjendjes mesatare ekonomike, nuk ka qenë i dënuar më parë për vepër tjetër penale dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

### Ë s h t ë f a j t o r

Sepse,

Me datë 27 Korrik 2023 rreth orës 19:00 min, në .....i pandehuri S.B., me dashje ka bërë dëmtimin e pronës së huaj, ashtu që për shkak të rastit të ndodhur si në dispozitivin e parë të aktakuzës (përkatësisht përshkak se D. S. dhe së bashku me të pandehurin N. S. e sulmojnë fizikisht të dëmtuarin S. B., duke e goditur me grushta në kokë dhe pjesë të ndryshme të

trupit), i pandehuri nga toka e merr një kubëz betoni dhe me të njejtën ia thyen xhamin e përparmë të veturës së markës .....me tabela të regjistrimit ..... pronë e të dëmtuarit F. H., kështu që i pandehutir me veprimet e tij të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm në vlerë të papërcaktuar.

-me çka ka kryer veprën penale, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të neneve 4, 38, 40, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, lidhur me nenin 242, 364 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin S. B.e,

## **G J Y K O N**

Me dënim me **gjobë** ( të holla) në shumë prej nga **250 € (dyqind e pesëdhjetë euro)**, të cilën shumë ka për ta arkëtuar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, në të kundërtën i njëjti dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu, ashtu që për çdo 20 € do t'i llogaritet nga një ditë burgu, si dhe

Pala e dëmtuar, F.H. H.nga ....., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri S. B., që në emër të paushallit gjyqësor të arkëtoj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu të akuzuarit obligohen që në kuptim të nenit 36, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguajnë shumën prej nga 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.1226/2023, të datës 06.09.2023, ka kërkuar që ndaj të pandehurve: N. S.dhe D.S. nga ....., për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 185, paragrafi 1, nën paragrafin 1.4 të KPRK-së dhe S.B. nga ....., për shkak të veprës penale: asgjësimi apo dëmtimi i

pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-së, të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, të shpallën fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të pandehurve për dat. 02.04.2024, në të cilën seancë, kanë marrë pjesë prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu dhe i pandehuri S.B., ndërsa kanë munguar të pandehurit N. S. dhe D.S.dhe sipas konstatimit të dorëzuesit të postës të njëjtit ndodhen me punë në Gjermani. Në fillim të kësaj seance gjyqësore, i pandehuri S., me qëllim të mos zvarritjes së procedurës penale ndaj tij , i propozon gjykatës, që ndaj të pandehurve N.S. dhe D. S., të veçohet procedura penale, të cilin propozim nuk e kundërshton prokurorja e shtetit. Gjykata duke vepruar sipas propozimit të pandehurit S. B., e në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 35 të KPPRK-së, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës penale me Aktvendim e ka veçuar procedurën penale ndaj të pandehurve N. S. dhe D. S., e cila procedurë penale ndaj të njëjtëve do të zhvillohet dhe përfundohet ndaras me vendim të veçantë, pranë kësaj gjykate. Në të cilën seancë gjyqësore pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i pandehuri S. B. deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, njëherit deklaroi se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i pandehuri S. B., me dashje e ka kryer veprën penale: asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, për të cilën veprën penale, gjykata të pandehurin e shpalli fajtor, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë, gjykata nuk është lëshuar fare në administrimin e provave të propozuara si në aktakuzë, por drejtë është shkuar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu me rastin e paraqitjes së fjalës përfundimtare deklaron se në shqyrtimin e sotëm fillestar i pandehuri S. B., e pranoj fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, pranimin e fajësisë i njëjti e bëri vullnetarisht pa ndikim të dhunës, me pranimin e fajësisë u vërtetua gjendja faktike ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës lëndore, me që u vërtetua gjendja faktike mbetet pranë aktakuzës dhe propozimeve të cilat e njëjta i përmban. Andaj kërkon nga gjykata që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të njëjtin ta dënojë me dënim të paraparë me ligj, duke i marr parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese po ashtu edhe ato rënduese, në mënyrë që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale.

I akuzuari S.B.në fjalën përfundimtare deklaron se e pranon fajësinë, ka gabuar, është penduar, por këtë e ka bërë për faktin se në atë moment ka qenë shumë i mllëfosur dhe për shkak se të njëjtit (D. S. dhe N.S.) paraprakisht e kanë sulmuar fizikisht në prezencën e anëtarëve të tjerë të familjes , se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe i premtion gjykatës se më nuk do të kryej këso vepra penale apo të tjera, të tilla, andaj kërkon nga gjykata që nëse eventualisht gjen prova dhe e shpall fajtor, mundësisht t'i shqiptoj një dënim sa më të butë konform ligjit.

Gjykata, me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarit për këtë veprë penale të kryer, vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në shqiptimin e drejtë dhe meritort të dënimit ligjor. Për këtë rast si rrethana lehtësuese pati parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ka gabuar, është penduar thellë për veprën penale të kryer, i premtion gjykatës se më nuk do të kryej këso vepra apo të tjera penale, faktin se përherë të parë ka rënë ndesh me ligjin dhe se ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, po ashtu gjykata si rrethanë lehtësuese pati parasysh edhe faktin se i njëjti paraprakisht ka qenë i prokura dhe i sulmuar fizikisht nga dy të pandehurit e tjerë-D.S.dhe N.S.. Ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese për të pandehurin, andaj duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, peshën e veprës penale të kryer dhe mënyrën e kryerjes së saj, i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit. Gjykata, po ashtu vlerësoi se edhe me këtë dënim, do të arrihet qëllimi i dënimit,

si dhe do të ndikoj pozitivisht në përmirësimin e të pandehurit që në të ardhmen të mos kryej vepër penale të këtillë apo të ngjashme.

Pala e dëmtuar, F. H. H. nga ....., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata, bazuar në nenin 452 paragrafi 1 KPP-së-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (Njëzetë euro), si dhe 20 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Pas shpalljes së aktgjykimit, në kuptim të nenit 367 të KPPRK-së palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2023:189142, 02.05.2024**

**G j y q t a r i**

Sadri Krasniqi,d.v.

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.